

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit E. A nga Gj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 dhe 3 nënparagrafi 3.2 lidhur me paragrafi 1.4 të (KPRK), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Ilmi Dalipi nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.796/2017, e datës 08.06.2017, të cilën e përfaqësonte prokuroren i shtetit Huma Jetishi , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar dhe publik, më datën 12.06.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari E.A, nga babai A. dhe nëna A e lindur S, i lindur më..., në Gjilan, ku edhe jeton,në rr.,, „me nr. në Gj.shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, i papunë, i gjendjes së rëndë ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme , student i gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka qenë i dënuar me parë për vepra tjera penale,

Është fajtor

Sepse me datë 14.05.2017, rreth orës 07:30, ne rrugën,, ,, në banesën e tyre të përbashkët, i pandehuri E. H. pas një mosmarrëveshje me nënën e tij tani të dëmtuarën A. S, për para në vlerë prej 50 euro, të cilat ia kërkonte kinse për ekskursion, dhe në momentin kur e dëmtuara nuk kishte mundësi për t,ia siguruar, për një moment i pandehuri e kap me duar për fyti dhe flok, duke e goditur me grushta nëpër të gjitha pjesët e trupit, më pas e merr edhe një thikë të kuzhinës, mjet i përshtatshëm për shkaktimit të lëndimit të rëndë trupor ose dëmtimit të rëndë të shëndetit, gjuan të dëmtuarën por fatmirësisht e njëjta arrin të largohet i shpëton më të keqes, dhe si pasojë e lëndimeve, e njëjta detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gj, ku edhe posedon raportin mjekësor me nr.... të dat.14.05.2017 dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës me veprimet e tija të kundërligjshme i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore.

-me qka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 dhe 3 nënpragrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të të KPRK.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 62,69, 73 , 74 ,76 dhe 83 të KPRK, si dhe nenit 365 e 463 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit E. A, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, të cilin dënim i akuzuari do ta mbaj në afat prej 15 ditëve , nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Koha e kaluar në paraburgim e te pandehurit prej 14.05. 2017 e deri me 12.06.2017, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar si më lart.

Poashtu të akuzuarit i konfiskohet një thikë kuzhine dhe një boks i hekurt.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, si dhe shpenzimet e ekspertizës mjekësore në shumë prej 20 Eurove, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit E. A nga Gj, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 2 dhe 3 nënpar.3.2 lidhur me paragrafin 1.4 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 12.06.2017, Prokurorja e Shtetit në Gjilan, Huma Jetishi, gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë akuzës së lartcekur, duke i propozuar gjykatës të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. A, avokati ...nga Gj, ka kërkuar nga gjykata që i akuzuari të dënohet sa më butë, mundësisht me një dënim me kusht.

I akuzuari E. H, gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar shprehi keqardhje për rastin që ka ndodhur, ndërsa ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptojë një sa më të butë, ngase jam mbajtës i familjes si dhe premtoj se gabimin e tanishëm më kurrë nuk do ta përsëris.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari E. H, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranohet fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjyqtari, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit të të akuzuarit, avokatidhe të dëmtuarës, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 i KPPK për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat nga neni i lartcekur i KPPK.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari..., me dashje e ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 2 e 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1.4 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari, e shpalli fajtor të akuzuarin ...nga Gj, për shkak të veprës penale të lartcekur, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 dhe 76 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, me, sjelljen e tij të mirë gjatë shqyrtimit gjyqësor, se ka shprehur keqardhjen për ndodhjen e këtij rasti, ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari i ka shkaktuar të dëmtuarës nënës së tij A pashtu atij ia zbuti dënimin nën minimumin ligjor, konform nenit 76 të KPP-së, ngase vepra penale është kryer brenda në familje si dhunë në familje, e dënimi më i madh, do të ndikonte në prishjen e raporteve familjare dhe do të lente pasojat edhe te fëmijët e tyre.

Gjyqtari, fillimisht gjatë shqyrtimit gjyqësor, të akuzuarit..., i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, të cilin dënim i akuzuari do ta kishte mbajtur pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Sipas bindjes së gjyqtarit, shqiptimi i dënimit me gjobë, ndaj të akuzuarit..., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, sipas nenit 41 të KPRK.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar, është i bazuar në nenin 83 të KPRK.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë duke u bazuar në nenin 62 dhe 69 të KPRK, kurse vendimi mbi shpenzimet e ekspertizës mjekësore si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 463 paragrafi 1 të KPPK.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 12.06.2017

**Zyrtarja ligjore,
Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimi të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.